



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr 51 Datë.24/12/2025

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit për Buxhetin e Vitit 2026; ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 35, datë 13.09.2024, mbi zbatimin e VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave”; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 50, datë 23.12.2024, “Mbi miratimin e strukturës organizative, klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2025”; si dhe Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 14, datë 22.05.2025, “Mbi miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2025”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2026, sipas tabelës sqaruese bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondi i pagave, i miratuar për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës dhe Buxhetit si dhe Sektori Juridik, i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI

Petrika Tolluci

Konceptoi: M.Shkurti

Pranoi: R.Latollari

Miratoi: M.Aliçkolli

Konfirmoi: Sek. K.Q.K. B.Mugo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. 711 Prot.

Korçë, më 12.12.2025

RELACION

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit për Buxhetin e Vitit 2026; ligjit nr. 152, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM-së nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 35, datë 13.09.2024, “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave”; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 50, datë 23.12.2024, “Mbi miratimin e strukturës organizative, klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2025”; si dhe Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 14, datë 22.05.2025, “Mbi miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës në Këshillin e Qarkut Korçë për vitin 2025”,

Struktura organizative dhe klasifikimi i nivelit të pagave të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2026, do të jetë si më poshtë:

I. KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Mban pozicionin si funksionar i zgjedhur nga Këshilli i Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në lidhjen nr. 1, pika “d”, të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024.

II. ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Mban pozicionin si funksionar i zgjedhur nga Këshilli i Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në lidhjen nr. 1, pika “d”, të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024.

III. SEKRETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Këshilli i Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën 3, shkronja “c”, dhe janë të konfirmuara në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024; përkatësisht i përket Kategorisë “I”, Klasës “1–5”, me grup diplome “1”.

IV. KABINETI I KRYETARIT

Kabineti i Kryetarit është strukturë ndihmëse, e përbërë nga funksionarë të emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse të drejtpërdrejta për realizimin e funksioneve politike, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për Shërbimin Civil”, i ndryshuar.

Përbërja e Kabinetit të Kryetarit është si më poshtë:

1. Drejtor i Kabinetit të Kryetarit dhe Këshilltar për Projektet e Bashkimit European

Është punonjës i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe pjesë e stafit ndihmës të Kabinetit të Kryetarit. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën 3, shkronja “c”, dhe janë të konfirmuara në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “I”, Klasën “1–5” dhe grupin e diplomës “1”.

2. Këshilltar Juridik i Kryetarit

Është punonjës i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe pjesë e stafit ndihmës të Kabinetit të Kryetarit. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën 3, shkronja “ç”, dhe janë të konfirmuara në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “II”, Klasën “II–2” dhe grupin e diplomës “1”.

3. Këshilltar për Marrëdhëniet me Publikun

Është punonjës i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe pjesë e stafit ndihmës të Kabinetit të Kryetarit. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën 3, shkronja “ç”, dhe janë të konfirmuara në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “II”, Klasën “II–2” dhe grupin e diplomës “1”.

V. SEKTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Në përbërjen e këtij sektori janë tre nëpunës civilë, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar:

1. Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “III”, Klasën “III–2” dhe grupin e diplomës “1”.

2. Specialist për Arkiv / Protokoll

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “IV”, Klasën “IV–2” dhe grupin e diplomës “1, 2 ose 3”.

3. Specialist për Financën dhe Buxhetin

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “IV”, Klasën “IV–2” dhe grupin e diplomës “1, 2 ose 3”.

VI. SEKTORI JURIDIK, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Në përbërjen e këtij sektori janë tre nëpunës civilë, dy janë në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe një punonjës administrativ, si më poshtë:

1. Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “III”, Klasën “III–2” dhe grupin e diplomës “1”.

2. Specialist Jurist

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “IV”, Klasën “IV–2” dhe grupin e diplomës “1, 2 ose 3”.

3. Shofer autoveture i institucionit

Është punonjës administrativ. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën “11 dhe 12” të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023.

VII. SEKTORI I PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në përbërjen e këtij sektori do të jenë katër nëpunës civilë, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar:

1. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit dhe Çështjeve Sociale

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në lidhjen nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “III”, Klasën “III-2” dhe grupin e diplomës “1”.

2. Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “IV”, Klasën “IV-2” dhe grupin e diplomës “1, 2 ose 3”.

3. Specialist për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale, Arsimin dhe Kulturën

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “IV”, Klasën “IV-2” dhe grupin e diplomës “1, 2 ose 3”.

4. Specialist për Programet e Zhvillimit

Është nëpunës në shërbimin civil. Klasa dhe kategoria e pagës për këtë pozicion përcaktohen në pikën nr. 7 të VKM-së nr. 503, datë 01.08.2024, të klasifikuar në Kategorinë “IV”, Klasën “IV-2” dhe grupin e diplomës “1, 2 ose 3”.

Struktura Organizative e miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut nr. 14, datë 22.05.2025, nuk do të pësojë ndryshime për vitin 2026.

Për të gjithë punonjësit që janë pjesë e Strukturës Organizative të Këshillit të Qarkut është vendosur niveli maksimal i pagave bazuar në VKM-në nr. 503, datë 01.08.2024. Mbi këtë nivel është llogaritur edhe fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe vjetërsisë në punë, të cila janë parashikuar në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2026.

Sa më sipër paraqesim për miratim strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2026.

NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Redin Latollari

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2026

Tabela sqaruese bashkëngjitur projekt vendimit për strukturën organizative:

Nr.	Njësia strukturore	Nr. Punonjësve	Kategoria	Grupi i diplomës	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Paga e pozicionit	Statusi i punonjësit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 1/d			260,000	Të zgjedhur
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 1/d			205,000	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 7, I-5	1	14000	170,000	Të emëruar nga Këshilli i Qarkut
Kabineti i Kryetarit							
IV	Drejtor i kabinetit të kryetarit	1	Lidhja 7, I-5	1	14000	170,000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
	Këshilltar Juridik i Kryetarit	1	Lidhja 7, II-2	1	14000	140,000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
	Këshilltar për Marrëdhëniet me Publikun	1	Lidhja 7, II-2	1	14000	140,000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
Sektori i financës dhe buxhetit							
V	Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit	1	Lidhja 7, III-2	1	14000	105,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Financën dhe Buxhetin	1	Lidhja 7, IV-2	1, 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	80,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Arkiv/ Protokoll	1	Lidhja 7, IV-2	1, 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	80,000	Pozicion pune shërbimi civil
Sektori Juridik, burimeve njerëzore dhe shërbimeve							
VI	Përgjegjës i Sektorit juridik, burimeve njerëzore dhe shërbimeve	1	Lidhja 7, III-2	1	14000	105,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Jurist	1	Lidhja 7, IV-2	1, 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	80,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Punonjës administrativ (Shofer)	1	Pika 11 dhe 12 VKM 328/2023			47,000	Pozicion pune me kontratë
Sektori i projekteve të zhvillimit dhe Çështjeve Sociale							
VII	Përgjegjës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit dhe Çështjeve Sociale	1	Lidhja 7, III-2	1	14000	105,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit	1	Lidhja 7, IV-2	1, 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	80,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Shëndetsinë dhe Çështjet Sociale, Arsimin dhe Kulturën	1	Lidhja 7, IV-2	1, 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	80,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Programet e Zhvillimit	1	Lidhja 7, IV-2	1, 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	80,000	Pozicion pune shërbimi civil
Totali nëpunësve në Administratë		13					

KRYETARI
Petrika Tolkuçi



STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS SË DAMT-së PRANË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2026

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës							
Nr.	Njësia strukturore	Nr. Punonjësve	Kategoria e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Paga e pozicionit	Statusi i punonjesit
I	Drejtor	1	III -1	1	14000	115,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Zyra Korçë	1	IV-3	1, 2 ose 3	14000	70,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Zyra Korçë	1	IV-3	1, 2 ose 3	14000	70,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Zyra Korçë	1	IV-3	1, 2 ose 3	12000	70,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Zyra Pogradec	1	IV-3	1, 2 ose 3	14000	70,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Zyra Devoll	1	IV-3	1, 2 ose 3	12000	70,000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist Zyra Kolonjë	1	IV-3	1, 2 ose 3	10000	70,000	Pozicion pune shërbimi civil
Totali i administratës së DAMT-së		7					

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) është funksion i deleguar nga ministria e Bujqësisë pranë Këshillit të Qarkut Korçë

KRYETARI
Petrika Tollkuçi

